



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2024-008

Nënkryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës – Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga pala R.M., ndaj kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, M.T., më datë 13.08.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e R.M., e parashtruar ndaj kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, M.T..

A r s y e t i m

Në Gjykatën Supreme më 15 korrik 2024, përmes Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është pranuar ankesa disiplinore e R.M., e parashtruar ndaj kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, M.T..

Pala ankuese, në ankesën e tij ka paraqitur pretendimet e tij, se në Gjykatën Themelore në Ferizaj qëndrojnë të pazgjidhur 2 civile kontestimore, njëra prej tyre që 9 vjet ndërsa dy rastet kontestimore mbi 5 vjet, duke shtuar tutje se ka më shumë se 5 vite që parashtron kërkesa për takim me kryetarin e gjykatës por që vetëm para dy muajve ka arritur të marrë përgjigje verbale lidhur me këtë. Tutje ankuesi, thotë se dy javë para se të parashtronte ankesën ka qenë i interesuar që të dorëzojë një dokument tek kryetari i gjykatës z. T., pasi që ishte dakorduar me këtë të fundit mirëpo në momentin që ka hyrë në gjykatë, sigurimi ka ushtruar dhunë fizike sipas ankuesit, e gjithë kjo ka ndodhur pa arsye.

Me qëllim të vërtetimit të këtyre pretendimeve, kryetari i Gjykatës Supreme, si autoriteti kompetent ka kërkuar deklaratë nga kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, M.T., si dhe ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës.

Në deklaratën e tij, kryetari theksoi se nuk qëndrojnë pretendimet e ankuesit sa i përket kërkesave për takim, ankuesin është pritur në takim tri herë, më datat 1 tetor 2021, 5 qershor 2024 si dhe 11 korrik 2024, herën e fundit nga nënkryetarja e gjykatës. Sa i përket pretendimeve rreth lëndëve të tij, në deklaratë thuhet se në gjykatë figurojnë të jenë 2 lëndë kontestimore që janë të papërfunduar e për të cilat është caktuar shqyrtimi gjyqësor për datën 10 shtator 2024, dhe se të njëjtat janë trajtuar nga ana e gjyqtarëve pa neglizhencë. Sa i përket lëndëve penale, seancat gjyqësore janë shtyrë për shkak mungesës së palëve por edhe vet të akuzuarit R.M., i cili gjithashtu nuk është paraqitur në Institutin e Forenzikës për ekzaminim psikiatrik sipas urdhëresës së gjykatës. Ndërsa sa i përket pretendimit se punëtorët e sigurimit kanë ushtruar

dhunë fizike ndaj tij, në deklaratën e kryetarit T., thuhet se nga zyrtarët e sigurimit është njoftuar se parashtruesi i ankesës në këtë rast, nuk ka përfillur rregullat e institucionit dhe ka tentuar të vijë në zyrë të kryetarit, pa iu lejuar një gjë e tillë dhe se për një gjë të tillë është njoftuar policia.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklaratës së kryetarit, si dhe provave të cilat ia ka bashkëngjitur deklaratës, vlerësoi se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës si dhe deklaratës së kryetarit rezulton se të gjitha pretendimet e palës ankuese, janë joserioze dhe se nuk konsumojnë ndonjëherë nga shkeljet disiplinore të parapara në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Si autoritet kompetent pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresat e lëndës, kam konstatuar se nuk qëndron pretendimi i palës se kryetari i gjykatës nuk iu është përgjigjur kërkesave të tij. Sa i përket pretendimit të palës se lëndët e tij nuk janë duke u trajtuar nga gjykata, del se në rastin konkret lëndët e tij kontestimore janë duke u trajtuar nga gjykata dhe se për të njëjtat është caktuar shqyrtimi gjyqësor ndërsa sa i përket çështjeve penale vonesa është shkaktuar për shkak të palës, në atë rast të akuzuarit R.M., i cili nuk është paraqitur në Institutin e Forenzikës, për ekzaminim psikiatrik. Ndërsa i njëjti nga gjykata është larguar për shkak shpërfaqjes së mos respektit ndaj gjykatës dhe rregullave të institucionit, veprime ndaj të cilave sigurimi i gjykatës ka paraqitur njoftim.

Duke u bazuar në këto, kryetari i Gjykatës Supreme vlerëson se një ankesë e tillë në bazë të këtyre pretendimeve është e pabazuar, dhe se për shkak se në parashtrësën e palës, nuk potencohet ndonjë shkelje konkrete e supozuar disiplinore ndaj kryetarit, të cilat janë të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mejreme Memaj
Nënkryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj,
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.